



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 400/01-29832, dt. 29 Maj 2025.

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit privat Xhemë (Arif) Rexhbogaj me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 29 Maj 2025, mori këtë:

VENDIM

Nr. 33/2025

Mbi këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të pronarit privat me qëllim: "Të Formimit të Hapësirës së Hapur Rekreative dhe Gjelbërim" si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të formimit të hapësirës së Hapur Rekreative dhe gjelbërim si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.
- II. Parcela kadastrale nr: 237-9 në sipërfaqe prej 387m² ZK Pejë- me shtëpi, pronë e pronarit Xhemë (Arif) Rexhbogaj do të merret me qëllim të formimit të hapësirës së Hapur Rekreative dhe gjelbërim si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe në të njëjtën kohë do të jetë objekt këmbimi me ngastrat kadastrale numër 5755-116 në sipërfaqe prej 1721m² ZK Pejë, nr. 3440-18 në sipërfaqe prej 145m² ZK Pejë, nr. 5716-6 në sipërfaqe prej 471m² ZK Pejë, nr. 4498-42 në sipërfaqe prej 560m² ZK Pejë, nr. 2213-1 në sipërfaqe prej 99m² ZK Pejë si dhe ngastra 3385-10 në sipërfaqe prej 140 m² ZK Pejë pronë Komuna e Pejës.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Vlerësimet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme të aprovuara me datën 29.05.2025.

-Pronat e Komunës së Pejës janë vlerësuar me sa vijon:

- ngastra kadastrale nr.5716-6 në sipërfaqe prej 471m² ZK Pejë është vlerësuar me 280.00 €/m² që në total i bie 131,880.00 €;
- ngastra kadastrale nr.3385-10 në sipërfaqe prej 140m² ZK Pejë është vlerësuar me 300.00 €/m² që në total i bie 42,000.00 €;
- ngastra kadastrale nr.2213-1 në sipërfaqe prej 99m² ZK Pejë është vlerësuar me 380.00 €/m² që në total i bie 37,620.00 €;
- ngastra kadastrale nr.4498-42 në sipërfaqe prej 560m² ZK Pejë është vlerësuar me 180.00 €/m² që në total i bie 100,800.00 €;

- ngastra kadastrale nr.3440-18 në sipërfaqe prej 145m² ZK Pejë është vlerësuar me 380.00 €/m² që në total i bie 55,100.00 € dhe
- ngastra kadastrale nr.5755-116 në sipërfaqe prej 1721m² ZK Pejë është vlerësuar me 80.00 €/m² që në total i bie 137,680.00 €.

Pra, ngastrat kadastrale me pronar **Komuna e Pejës** janë vlerësuar në total: **505,080.00 €**.

-Prona private e pronarit **Xhemë (Arif) Rexhbogaj** me numër të ngastrës 237-9 në sipërfaqe prej 387m² ZK Pejë është vlerësuar me 320.00 €/m² dhe vlera e investimeve 136,450.00 €, që në total i bie **260,290.00 €**.

- Andaj obligohet Xhemë (Arif) Rexhbogaj që të paguajë diferencën në shumën prej **244,790.00 €** Komunës së Pejës bazuar në Vlerësimin e bërë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti për Vlerësimin e Pronave të Paluajtslune.

- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do t'i nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike.
- VI. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:
MAPL,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ- së
Arkivës.



KRYESUESI I KUVENDIT,
Rexhep Kurtbogaj